

**“PËRPJEKJET PËR REFORMIMIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE NË
KOSOVË DHE SFIDAT GJATË VITEVE 2010-2020”**

**EKSPOZE E TEMËS SË MASTERIT
NGA KALTRINA LLESHI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
SHKENCAT POLITIKE
PRISHTINË**

EKSPOZE

Mentor: Prof.Dr. Afrim Hoti

Administrata publike përfaqëson një grup të njerëzve dhe të kompetencave të cilat janë të strukturuar në formë hierarkike, që kanë për qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e të mirave publike në të mirë të qytetarëve. Administrata Publike është një nga segmentet kryesore ku përmes të cilës realizohen marrëdhëniet në mes shtetit dhe shoqërisë. Funksionimi i një shteti vihet në pah përmes efikasitetit të administratës shtetërore dhe gjithashtu shërben si ndërlidhje në mes të qytetarëve dhe qeverisë ku edhe konsiderohet si një motor i shtetit. Administrata publike është segment thelbësor që lidh qytetarin me organet udhëheqëse brenda shtetit modern. Administrata publike i referohet mekanizmit dhe institucioneve përmes së cilëve zbatohen rregulloret publike, apo disiplinat akademike që merren me këto mekanizma. Reforma e administratës publike në Kosovë është një pjesë thelbësore e procesit të shtetndërtimit. Me reformën administrative qeveria synon të modernizojë administratën publike, për të forcuar kapacitetet e saj dhe për ta bërë atë më efikase dhe më të përgjegjshme. Reformimi i saj është në funksion të përputhjes së kornizës ligjore dhe zbatimit të saj në praktikë me legjislacionin e BE, e rrjedhimisht përmes përafrimit të legjislacionit të arrihet në plotësimin e kritereve politike të përcakturara nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Procesi i ndërtimit të shtetit nuk mund të paramendohet pa veprimtarinë e një administrate efikase dhe të gatshme për të shërbyer. Reforma e Administratës Publike është një proces dinamik që synon rritjen e kapaciteteve të saj për ofrimin e shërbimeve publike. Në Kosovë ky proces në masë të madhe vazhdon të shtyhet nga faktorët e jashtëm, nga perspektiva dhe agjendat e Bashkimit Evropian dhe nga donatorët e tjerë. Reformat në administratën publike janë kërkesë e vazhdueshme për ngritjen profesionale dhe depolitizimin

e saj. Këto reforma ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve, si dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve si dhe mundohen të krijojnë një administratë publike të organizuar, të kualifikuar dhe të përgjegjshme. Duke e ditur rëndësinë e Administratës Publike në formimin dhe funksionimin sa më të mirë të shtetit kam vendosur të bëjë këtë hulumtim rreth reformave të Administratës Publike. Ky punim i shërben studimeve të fushës së njejtë dhe gjithashtu shërben për të kuptuar më mirë dhe më gjerë se si ka arritur Kosova të përmbushë standartet dhe parimet kryesore që ndihmojnë në krijimin e një Administrate moderne, efikase dhe transparente dhe gjithmonë e gatshme të ju shërbejë qytetarëve në mënyrë efikase. Metodologjia e përdorur në këtë punim hulumtues është metoda kualitative me të dhëna cilësore ku grumbullimi i të dhënave është bazuar në burime sekondare sic janë publikimet e raporteve të Komisionit Evropian dhe raportet e OECD dhe SIGMA dhe raporte të tjera të cilat kanë monitoruar dhe analizuar procesin e reformimit të Administratës Publike.

Ky punim konsiston në gjetjen e progresit të arritur nga Administrata Publike në procesin e reformimit të saj si dhe sfidat aktuale që po përballen administrata publike gjatë përpjekjes së vazhdueshme të reformimit të saj. Punimi është i ndarë në katër kapituj.

Në kapitullin e parë kemi hyrjen dhe metodologjinë ku do të kemi një hyrje rreth administratës publike dhe do të përmendim metodat dhe qasjet që i kemi përdorur gjatë punimit hulumtues.

Në kapitullin e dytë trajtohet administrata publike nga këndvështrimi teorik e më pas brenda këtij kapitulli do të shqyrtohet historiku i administratës publike pas pavarësisë dhe tutje synohet të përshkruhet Administrata Publike dhe Marrëveshja për Stabilizim Asociim dhe gjithashtu rrethanat e marrëveshjes në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Në kapitullin e tretë pasqyrohen zhvillimet e fundit të bëra gjatë përpjekjeve të reformimit të administratës publike ku përfshihen parimet, reformimi i kornizës ligjore dhe organizimi strukturor i administratës publike.

Në kapitullin e katërt do të analizohen mangësitë dhe sfidat aktuale të përpjekjeve për reformimin e administratës publike si dhe rekomandimet aktuale drejtë përpjekjeve të reformimit të Administratës Publike.

SHTATOR, 2021